

Imagjinata sociologjike **Fatos TARIFA, PhD**

(Shkruar posaçërisht me rastin e themelimit të Institutit Shqiptar të Sociologjisë)

(Botuar në "Tirana Observer", date 23 nëntor 2006)

Si shumë sociologë të tjerë, unë besoj se sociologjia, si disiplinë akademike dhe si shkencë e aplikuar, premtion se mund të ndihmojë në krijimin e një botë më të mirë dhe më të drejtë. Është pikërisht për këtë shkak, që unë zgjedha, njëzet vjet më parë, të bëhem sociolog. Është po për shkak të këtij premtimi që unë kam ruajtur dhe vazhdoj të ruaj shpresën për një shoqëri dhe një botë më të mirë, në një kohë thuajse të pashpresë. Unë mendoj se e vetmja mënyrë, përmes së cilës ne, si sociologë, mund ta mbajmë gjallë këtë shpresë dhe të arrijmë ta shohim atë të realizuar, është të fillojmë të vejmë në jetë të atë lidhje vitale që duhet të ekzistojë midis njohjes, veprimtarisë shoqërore dhe rezultateve të saj. Unë besoj se sociologjia përmban në vetvete premisat, kontekstin dhe strukturat e nevojshme për të mundur këtë lidhje: Të thellojë njohjen njerëzore, ta transformojë këtë njohje në veprimtari praktike shoqërore të dobishme dhe të ndikojë mbi rezultatet e saj duke i parashikuar ato.

Një kuptim i tillë i sociologjisë natyrshëm kërkon t'i jepet përgjigje një çështjeje shumë të rëndësishme, e cila ka të bëjë me marrëdhëniet që ekzistojnë midis politikës së procesit njohës, formulimit të dijes sociologjike dhe mënyrës se si kjo dije mund dhe duhet të "përkthehet" në veprimtari praktike shoqërore. Me fjalë të tjera, kjo pyetje mund të formulohet në këtë mënyrë: çfarë synojmë ne kur bëjmë sociologji.

Politika e procesit njohës

Sipas sociologut amerikan Ernest Boyer, në kontekstin akademik procesi njohës mund të konsiderohet si zbulim, integrim, aplikim dhe mësim. Me zbulim kuptohet ajo që zakonisht e quajmë kërkim shkencor, apo "scientific research". Kërkimi akademik është esencial për disiplinën e sociologjisë dhe për vetë suksesin tonë si akademikë. Veprimtaria kërkimore serioze në shkencë është padyshim ndër aktivitetet intelektuale më prestigjioze. Në vendet e zhvilluara ajo financohet gjerësisht nga institucione të interesuara dhe pasqyrohet në revistat akademike më të mëdha.

Ka sociologë, të cilët, për të mbrojtur disiplinën e tyre nga ata që, siç shprehet Joan Huber, nuk besojnë në "standardet e racionalitetit, të objektivitetit, apo të së vërtetës", argumentojnë se esenca e dijes sociologjike është pozitiviste. Norman Denzin, për shembull, argumenton se sociologë të tillë e nënvlehtësojnë sociologjinë jopozitiviste duke lënë pas dore veprimtarinë dhe kontributin teorik të sociologëve konstruktivistë dhe duke injoruar kompleksitetin gjithnjë e më të madh të problemeve shoqërore, zgjidhja e të cilave kërkon më shumë se sa mund të ofrojë një disiplinë e vetme apo një paradigmë brenda një discipline të caktuar.

Ky tension midis krijimit dhe mbrojtjes së sociologjisë si një disiplinë akademike legjitime dhe një këndvështrimi të mbështetur mbi vlera në studimin e shoqërisë, nuk është i ri. Ai ka shoqëruar për më shumë se një shekull e gjysmë zhvillimin e sociologjisë që nga lindja e saj, të cilën zakonisht e lidhim me emrin e mendimtarit francez August Comte. Karl Marx, për shembull, e vinte theksin në ndërjegjen kolektive klasore, ndërsa në dallim nga ai, Max Weber mbronte idenë se sociologjia, si shkencë, duhet të jetë e "çliruar nga vlerat" apo

indiferente ndaj tyre. Weber ishte veçanërisht i preokupuar mbi atë se si jepet mësim shkencë dhe sociologjia në shkollë. Në një fjalim të mbajtur në Universitetin e Mynihut më 1918, Max Weber i inkurajonte studentët të mos praninin që profesorët të injektonin në leksione pikëpamjet e tyre personale politike e morale. Ai sugjeronte që pikëpamjet dhe vlerat politike të mënjanoreshin nga procesi mësimdhënës përderisa qëllimi i këtij procesi është t'u mësojë studentëve shkencën si njohuri dhe për të vënë nën kontroll jetën shoqërore. Weber theksonte se të kuptuarit e fakteve jetësorë bëhet i pamundur sa herë që mësuesit injektojnë në shpjegimin e tyre vlerat dhe gjykimet e tyre personale.

Dy vjet më parë, më 1994, ky subjekt u bë fokusi i një debati shumë të nxehtë në Shoqatën Sociologjike Amerikane në kuadër të diskutimit mbi vendin dhe rolin e sociologjisë publike në shtratin e gjerë të disiplinës së sociologjisë. Kundërshtarët e nocionit "sociologji publike", të cilët pretendojnë se dalin në mbrojtje të sociologjisë si një sistem dijesh shkencore apo akademike, argumentojnë se sociologët nuk duhet të angazhohen apo të promovojnë axhenda politike, me fjalë të tjera, sociologët nuk duhet të jenë aktivistë për ndryshim shoqëror. Sipas tyre, mbajtja e një qëndrimi të caktuar moral apo politik nuk përputhet me objektivitetin shkencor.

Ndërsa mjaft sociologë të njohur, si Dorothy Smith, të cilën unë kam pasur nderin ta njoh dhe ta vizitoj në apartamentin e saj në Toronto, ku ajo banon, argumentojnë se është përgjegjësia e studiuesve të shkencave sociale t'i përdorin njohuritë e tyre për të mundësuar krijimin e një shoqërie më humane, të tjerë këmbëngulin në mbrojtje të sociologjisë si një shkencë pozitiviste. Një ndër ish presidentët e Shoqatës Sociologjike Amerikane, Joe Feagin, e cilëson këtë si një tension në sociologji midis atyre që janë të "përkushtuar në zgjidhjen e padrejtësive sociale" dhe atyre që dëshirojnë dhe preferojnë "të pranohen si shkencëtarë legjitimë nga shoqëria, sidomos nga elita në pushtet". Edhe pse çdo sociolog, në një mënyrë a në një tjetër, bën pjesë diku në këtë spektër (i cili fillon nga trasheja e luftës për drejtësi sociale në njërin ekstrem, në kompjuterin me të cilin kryejmë analiza statistikore, në ekstremin tjetër), ne si sociologë konfrontohemi shpesh me problemin e integritetit dhe të legjitimitetit të disiplinës së sociologjisë.

Transformimi i dijes në veprim

Nëse "prodhimi" i dijes sociologjike implikon çështje dhe dilema që kanë të bëjnë me vlerat morale dhe politikën, kjo është akoma më e vërtetë kur bëhet fjalë për atë se çfarë bëjmë ne me dijen sociologjike kur e "kemi" atë, pra, si e përdorim dijen sociologjike dhe për ç'qëllim. Me fjalë të tjera, si e transformojmë ne dijen sociologjike në veprim në funksion të një objektivi të caktuar shoqëror? Këtu pikërisht hyn në punë sociologjia e aplikuar, përmes së cilës ne përdorim metodat e kërkimit sociologjik dhe teoritë sociologjike për t'u dhënë zgjidhje problemeve të shoqërisë, të cilat kanë të bëjnë me individë apo grupe të caktuara shoqërore, organizata, institucione si edhe me vetë shoqërinë në tërësi.

Ky proces transformimi fillon në shkollë. Sociologjia amerikane Maxine Atkinson argumenton se "mësimi akademik është një proces që transmeton këndvështrime, talente dhe njohuri tek studentët, ndërkohë që vetë mësuesi mbetet një nxënës aktiv". Por kur dhe si mund ta dimë nëse të mësuarit e sociologjisë ka "ndodhur", apo "është kryer" në të vërtetë? Vetë Atkinson shprehet se ajo që provon se të mësuarit e sociologjisë ka "ndodhur" është "kur studentët mësojnë të vlerësojnë në mënyrë kritike faktet reale, të formulojnë argumente, të aplikojnë konceptet e mësuara në situata të reja si edhe të diferencojnë midis një strukture shoqërore dhe një ndërtese të bërë me tulla dhe çimento", me fjalë të tjera, kur studentët mësojnë të përdorin atë që C. Wright Mills e ka quajtur "imagjinatë sociologjike".

Të mësuarit e imagjinatës sociologjike është një arenë e rëndësishme në përpjekjet për të transformuar dijen në veprim, proces ky në të cilin studentët, si sociologë të ardhshëm, edukohen të jenë prakticienë socialë në rolet e tyre si qytetarë të vendit të tyre dhe si qytetarë të botës. Përfytyroni për një çast të jetosh në një botë, në të cilën njerëzit janë njohur me konceptin sociologjik të strukturës dhe u është dhënë mundësia të shkojnë përtej shpjegimeve individuale të problemeve sociale. T'u mësosh studentëve imagjinatën sociologjike, pra, t'u mësosh se si të imagjinojnë sociologjikisht, do të thotë t'u japësh atyre si qytetarë demokratë një mjet të fuqishëm për të kuptuar më mirë shoqërinë në të cilën jetojnë dhe për të mundësuar ndryshime sociale pozitive, të efektshme dhe të planifikuara.

Nevoja dhe dëshira për të aplikuar dijen sociologjike, apo për të praktikuar sociologjinë, ka në themel të saj, siç shprehet Allan Johnson, një ndjenjë të thellë morale, e cila ka të bëjë "me thelbin e asaj se ç'jemi dhe ç'përfaqësojmë ne si qenie shoqërore dhe nëse konsiston jeta jonë". Johnson argumenton se praktika e sociologjisë transformon tek ne mënyrën se si e shohim botën në të cilën jetojmë dhe si e përjetojmë atë si eksperiencë individuale dhe shoqërore, çka është "hapi i parë drejt mënyrave të reja për të marrë pjesë në të".

Pjesë integrale e qëllimit të të mësuarit të sociologjisë është gjithashtu përdorimi i pedagogjisë kritike, siç e gjejmë atë të zhvilluar tek Paulo Freire, që do të thotë t'u mësosh studentëve të mos e marrin të mirëqenë dominimin në shoqëri, por ta sfidojnë atë së bashku me besimet dhe praktikatat që u shërbejnë ruajtjes së kushteve që mundësojnë shtypjen shoqërore.

Pavarësisht kritikës që Max Weber u bënte profesorëve (dhe studiuesve) që nuk i mënjanonin vlerat e tyre nga mësimi i sociologjisë dhe kërkimi sociologjik, shumë sociologë besojnë se dija sociologjike nuk mund t'u komunikohet të tjerëve dhe as mund të praktikohet në praktikë e zhveshur nga vlerat që i karakterizojnë ata si individë njerëzorë dhe qytetarë. Autorja e famshme amerikane Toni Morrison, fituese e çmimit "Nobel" në letërsi më 1993, në një leksion të mbajtur në "The Princeton Center for Human Values", është shprehur: "Unë jap mësim atë që unë jam dhe ato vlera që kam". Sipas saj, vlerat individuale të dikujt "nuk janë të fshehura edhe pse ato mund të mos shprehen".

Por, nga se kuptohen, apo çfarë i bën evidente vlerat tona në auditor? Në radhë të parë, ato kuptohen nga literatura që u rekomandojmë studentëve të lexojnë, nga natyra e problemeve për të cilat i inkurajojmë ata të diskutojnë, nga mënyra se si e organizojmë orën e mësimi, nga ndërveprimi ynë me studentët dhe, siç shprehet Toni Morrison, nga mënyra se si e trajtojmë ne njëri tjetrin si kolegë të të njëjtit profesion, si edhe nga natyra e problemeve "të rrezikshme" dhe "jo të modës" që kemi interes dhe kurajë të studiojmë.

Qëllimi i "bërjes" sociologji

Unë vetë, nuk e fsheh, i jam përkushtuar kërkimit sociologjik dhe asaj forme mësimi të sociologjisë që nuk kërkon fshehjen apo mohimin e vlerave politike e morale që unë respektoj dhe mbroj pasi, njëlloj si Dorothy Smith, unë ndjej një përgjegjësi morale për t'i përdorur "mjetet" që ofron disiplina e sociologjisë në shërbim të progresit shoqëror dhe krijimit të një shoqërie më humane. Unë besoj se sociologjia ka aftësinë, siç shprehet Smith, të "zbulojë se si funksionon sistemi", duke u mundësuar qytetarëve të veprojnë për ndryshime progresive në shoqëri. Kjo, mendoj unë, mund të arrihet duke eksploruar atë që sociologu dhe futuristi i shquar amerikan Wendell Bell në Yale University e quan një "etikë globale që po krijohet", me çka ai kupton një sërë vlerash të përbashkëta si, përgjegjësia individuale, trajtimi i të tjerëve në atë mënyrë siç do të donim të trajtoheshim edhe ne prej

tyre, respekti për jetën, drejtësia ekonomike dhe sociale, ndershmëria, moderacioni, liria individuale (e shprehur në një mënyrë që nuk cenon lirinë e tjetrit), toleranca ndaj diversitetit, etj.

Imagjinata sociologjike mundëson një kornizë brenda së cilës në mund ta imagjinojmë botën të formuar sërish. Për shembull, praktika sociologjike e sociologes së njohur Elise Boulding i është përkushtuar punës me njerëz në shumë vende të botës që ndajnë me të besimin në krijimin e një kulture universale paqësore dhe të një bote pa armë. Një ndër hapat e parë që kjo sociologe inkurajon është që njerëzit kolektivisht të imagjinojnë botën në të cilën ata jetojnë ashtu siç do të dëshironin që ajo të ishte në të vërtetë (dhe siç do të dukej pa armë). Siç demonstroi qartë ajo, si sociologë në mund të krijojmë mundësinë për ndryshime në shoqëri duke parashikuar rezultatet që kërkojmë të arrijmë. Njëlloj si Elise Boulding, sociologja e njohur amerikane Judith Blau dhe sociologu spanjoll Alberto Moncada, bashkëthemelues të shoqatës "Sociologists without borders" (Sociologë pa kufi) dhe bashkëredaktorë të revistës Societies without Borders (Shoqëri pa kufi) besojnë se sociologët kudo në botë mund të bashkëpunojnë në dobi të krijimit të një bote, në të cilën të sundojnë drejtësia sociale, ku të mos ketë të uritur dhe të pastrehë dhe ku vlerat e njerëzve të mos bazohen në statusin ekonomik të tyre. Në përfundim dëshiroj të ndaj me ju këto fjalë të poeteshës së njohur amerikane Nikki Giovanni të mara nga një poezi e saj titulluar "A Very Simple Wish" (Një dëshirë shumë e thjeshtë): "Unë kam një mendim të ndërtoj një botë të re. Dëshiron të luash?".